




AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

1

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR
PËR MONITORIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE QERSHOR 2019 TË SUBJEKTIT
ELEKTORAL PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”
(Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)



Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





RAPORTI I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE"

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Monitoruesi-eksperti financiar (audituese ligjore): *Fatmira Kastrati*

Subjekti zgjedhor: *Partia "Aleanca Demokratike"*

Periudha e monitoruar: *01.06.2019-30.06.2019*

I. Informacion i Përgjithshëm

A. Informacion ligjor

i. Kuadri ligjor

Përbushja e detyrës sime si eksperte financiare për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor, Partia "Aleanca Demokratike", u krye sipas vendimit të KQZ-së, nr. 740, të datës 31.05.2019, dalë në zbatim të ligjit nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, datë 22.05.2017.

Baza ligjore

Realizimin e këtij misioni ka këtë bazë ligjore si më poshtë renditur:

- Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, kreu II, pjesa II e tij;
- Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017;
- Udhëzimin nr.1 të KQZ-së, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", i ndryshuar me vendimin nr 153, datë 11.04.2019 të KQZ-së "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr 1, datë 31.05.2017";
- Udhëzimin nr.2 të KQZ-së, datë 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore";
- Udhëzimin nr.3 të KQZ-së datë 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".
- Udhëzimi nr 1 të KQZ-së, datë 11.04.2019 "Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore";
- Vendimi nr 152, datë 11.04.2019 të KQZ-së "Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore",

i.a Kohëzgjatja e misionit

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Misioni i monitorimit u realizua nga data 01.06.2019 deri me 30.06.2019. Realizimi i tij është dokumentuar me 4 (katër) raportet e ndërmjetme të monitorimit, të cilat janë dorëzuar edhe elektronikisht, në format pdf, në KQZ (shpallur çdo javë dhe në faqen zyrtare të saj <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>), sipas kërkesave të udhëzimit nr 1, datë 11.04.2019 të KQZ-së, së "Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore", neni 6, pika 1 e tij.

3

i.b Fushë veprimi i monitorimit

Monitorimi u krye në zbatim të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike", i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, nenet 24/1-24/5 të tij dhe udhëzimit nr. 3 datë 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".

Synimi i këtij monitorimi kishte të bënte me:

- Përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partia "Aleanca Demokratike" gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
- Kontrollin e përputshmërisë së veprimtarisë së subjektit zgjedhor, partia "Aleanca Demokratike" me kushtet dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, neni 24/1-24/5 të tij për financimin dhe raportimin e shpenzimeve të fondeve financiare të përfituara nga partia politike gjatë fushatës zgjedhore të datës 30.06.2019 dhe të udhëzimit nr. 3 datë 2.06.2017 të KQZ-së "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore", nenet 2-4 të tij.
- Kontrollin për përdorimin e materialeve propagandistike sipas udhëzimit nr.1, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", i ndryshuar me vendimin nr 153, datë 11.04.2019 të Kqz-së "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr 1, datë 31.05.2017";

Monitorimi i fushatës zgjedhore u krye me anë të vëzhgimit në terren, të inspektimit, të verifikimit, të konfirmimit dhe të grumbullimit të informacionit për veprimtaritë dhe aktivitetet e subjektit zgjedhor, partia "Aleanca Demokratike" gjatë periudhës 01.06.2019-30.06.2019, siç është shkruar më sipër në pikën i.a.

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor partia "Aleanca Demokratike" u realizua duke përfshirë monitorimin për aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura nga subjekti zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në kontratën e shërbimit.

ii. Kontrata e shërbimit

Kryerja e misionit të monitorimit u realizua sipas kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 5047, datë 01.06.2019, të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe ekspertës financiare (audituese ligjore), znj. Fatmira KASTRATI, anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 14, datë 11.01.2000, me NIPT K46523036S.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
Njësia administrative 5 - Tiranë
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e monitorimit dhe auditimit të fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjekti zgjedhor, "Partia Aleanca Demokratike", për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

iii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi i KQZ-së, nr. 740, i datës 31.05.2019, "Për shpalljen e rezultatisë të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019", solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 5047, datë 01.06.2019, përshkruar më sipër në pikën ii.

iv. Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor dhe ekspertit financiar/monitoruesit

Sipas udhëzimit nr.2 të KQZ-së, datë 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore, nenit 3 të tij, kërkohet që:

"Ekspertët financiar të emëruar sipas këtij udhëzimi duhet të monitorojnë në mënyrë specifike:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- e) Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- f) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike."

Subjekti zgjedhor është i detyruar të lejojë ekspertin financiar të kryejë monitorimin në ambjentet ku ai kryen fushatën zgjedhore dhe t'i japë atij informacionet e nevojshme për qellimet e procesit të monitorimit.

Përgjegjësitë respektive të palëve, të subjektit zgjedhor dhe ekspertit financiar/monitoruesit janë të përcaktuara në kuadrin ligjor sa më sipër cituar në pikën i të këtij raporti.

B. PARAQITJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor, partia "Aleanca Demokratike"

Partia "Aleanca Demokratike" është krijuar me urdhërin nr. 13/1, datë 03.11.1992 të Ministrisë së Drejtësisë. Aktet e themelimit dhe të ndryshimeve të drejtimit të kësaj Partie janë të depozituara në regjistrin e partive politike, Drejtimi i sotëm i Partisë bëhet nga z. Eduart Abazi sipas vendimit nr. 6076, datë 22.05.2014, me nr. akti 8807 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Adresa zyrtare e selisë së Partisë është rruga "Murat Toptani", nr 10, Tiranë.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it



**ii. Struktura dhe objekti i raportimit të monitorimit**

Siç është theksuar edhe në paragrafin *i.b*, monitorimi është kryer me anë të vëzhgimit në terren, të inspektimit, të verifikimit, të konfirmimit dhe të grumbullimit të informacionit për veprimtaritë dhe aktivitetet e subjektit zgjedhor, partia “Aleanca Demokratike” gjatë periudhës 01.06.2019-30.06.2019, siç është shkruar në pikën *i.a*.

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor partia “Aleanca Demokratike” u realizua duke përfshirë monitorimin për aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura nga subjekti zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në kontratën e shërbimit.

Prandaj dhe raporti i monitorimit paraqet realizimin e këtij misioni sipas detyrave ligjore të përshkruara në pikën *i.b* dhe konkretisht përmbledh këto procese pune:

- a. Monitorimi i zyrave zgjedhore;
- b. Monitorimi i aktiviteteve, eventeve dhe materialeve të fushatës;
- c. Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor

ii.a. Monitorimi i zyrave elektorale të subjektit zgjedhor partia “Aleanca Demokratike”

Procesi i monitorimit të zyrave elektorale të subjektit zgjedhor, partia “Aleanca Demokratike” në 21 bashkitë ku ajo kishte shpallur kandidatët e saj për anëtarë të këshillave bashkiakë, u krye me qëllim identifikimin e numrit të zyrave, të madhësive dhe të shpërndarjeve të tyre për të parë pajtueshmërinë me numrin maksimal të zyrave të lejuara (1 zyrë për çdo lagje) dhe për të vlerësuar kostot e zyrave.

Pas njoftimit për rezultatet e shortit të dytë shpallur me vendimin e KQZ-së, nr. 740 të datës 31.05.2019, ardhur nëpërmjet postës elektronike nga zyra juridike e KQZ-së, me datë 31.05.2019, ora 17,59, fillova përmbushjen e detyrës sime si eksperte financiare për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, për subjektin zgjedhor, partia “Aleanca Demokratike” që me datë 01.06.2019.

- Me datë 01 qershor 2019, jam lidhur me telefon me kryetarin e Partisë, z. Eduart Abazi (nr. mob 0682046005), i cili më shpjegoi që fushata për ta jo vetëm nuk kishte filluar por edhe nuk dihej nëse do të fillonte.
- Me datë 03.06.2019, pasi jam paraqitur në KQZ për firmosjen e kontratës dhe tërheqjen e saj (por që nuk u arrit meqë ende nuk ishte bërë gati), kam bërë takimin në zyrat e Partisë, me kryetarin e saj, z. Eduart Abazi, nga ora 13,30-15, ku u parashtruan nga unë kërkesat për marrje informacioni sipas kërkesave ligjore për zyrat elektorale, vendndodhjet e tyre, planet për organizimin e aktiviteteve elektorale, listat e kandidatëve për kryetarë të bashkive dhe këshilltarë bashkiakë.
- Po në këtë datë, në orën 14,09 janë bërë fotot e ambjenieve të brendshme dhe të jashtme të selisë së Partisë, ku vërehet se nuk kishte asnjë material propagandistik për fushatë zgjedhore (shih edhe fotot në raportin e ndërmjetëm nr. 1 për periudhën 01¹).
- Me datë 04.06.2019, pas firmosjes së kontratës me KQZ-në (që është tërhequr me datë 05.06.2019, pasi është firmosur nga sekretari i përgjithshëm në këtë datë), jam paraqitur në zyrat e Partisë, por nuk kam gjetur asnjë person.²

¹ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 1 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.1-4

² Po aty, fq.4-5

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





AUDITUESE LIGJORE FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- I është dërguar email z. Eduart Abazi (abazieduart@hotmail.com) për të konfirmuar zyrtarisht pohimet e tij të datës 03.06.2019, i cili ka kthyer përgjigje, me datë 10.06.2019, ku konfirmon që nuk kanë kryer asnjë veprim për llogari të fushatës zgjedhore³.
- Në komunikimet nëpërmjet postës elektronike me z. Eduart Abazi (abazieduart@hotmail.com) dhe me mesazhet telefonike e në takimet në selinë e Partisë me të në datat 20.06.2019 dhe 25.06.2019 ku i janë parashtruar disa herë kërkesat për dhënie informacioni ligjor në lidhje me fushatën për zgjedhjet e qershorit 2019, kthen përgjigje zyrtare ku pohon se nuk kanë kryer asnjë shpenzim sepse nuk kanë kryer asnjë veprim si deri me datë 20 qershor 2019 ashtu dhe deri me datë 26.06.2019. Çdo ndryshim në planet e tyre do të më bëhej i njohur:⁴ Të njëjtën përgjigje kthen edhe me dt.26.06.2019⁵

Partia "Aleanca Demokratike" rezulton të ketë regjistruar kandidatët e saj vetëm për këshilltarë bashkiakë dhe jo për kryetarë bashkish në 21 bashki të vendit.

Kjo rezulton sipas listës shumë emërore për kryetarë bashkish dhe këshilltarë bashkiakë dërguar me email nga KQZ me datë 06.06.2019, ora 14,57 si dhe duke i krahasuar këto me informacionet e faqes zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/kandidate-per-keshilltar-bashkie/> dhe <http://cec.org.al/kandidate-per-kryetar-bashkie/>.

U është dërguar kërkesa ime zyrtare për dhënie informacioni nëpërmjet postës sime elektronike e nëpërmjet adresës elektronike: <https://pyetshtetin.al/category/kategorite/pushteti-vendor/page/11/> 13 bashkive nga 21 bashki që kjo Parti kishte regjistruar kandidatët e saj, meqenëse vetëm në këto bashki kishte adresa të personave të kontaktit nën emërtimin si punonjës të ngarkuar me detyrën për të drejtën e informimit, e konkretisht (shih emaillet përkatëse) bashkive Shkodër, Lezhë, Bulqizë, Dibër, Durrës, Shijak, Tiranë, Librazhd, Divjakë, Mallakastër, Kuçovë, Devoll, Korçë.⁶

Ndërsa 8 bashkive të tjera u është dërguar në rrugë postare kërkesa ime zyrtare për dhënie informacioni që janë bashkitë Tropojë, Has, Kukës, Mirditë, Prrenjas, Pogradec, Maliq, Këlcyrë (Përmet).⁷

U është dërguar edhe dy bashkive, Fier dhe Elbasan, përveçse iu ridërgua përsëri bashkive Korçë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës kërkesa ime nga llogaria personale <https://regjistri.pyetshtetin.al/shared-with-me>.⁸

Kërkesa zyrtare e imja e drejtuar 21 bashkive të vendit kishte këtë përmbajtje:

"Lënda: Kërkesë për dhënie informacioni sipas kërkesave të ligjit nr. 8580 "Për partitë politike", i ndryshuar, dhe udhëzimeve të KQZ-së Të nderuar!

Ju paraqes kërkesën time si më poshtë vijon:

Referuar nenit 24/4, pika 1, të ligjit nr.8580, dt.17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, udhëzimit të KQZ-së nr.2, dt.01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë", për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike dhe vendimit të KQZ-së nr 740 dt 31.05.2019 " Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019", **jam emëruar si eksperte financiare për monitorimin e fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore për vitin 2019.**

Në mbështetje po të nenit 24/4, pika 1, të ligjit nr.8580, dt.17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, udhëzimit të KQZ-se nr.1, dt.31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet e afshimit të tyre gjatë fushatës zgjedhore", ndryshuar me vendimin nr. 153 të KQZ-së, datë 11.04.2019, subjekti zgjedhor është i detyruar që jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse për adresat e sakta të

³ Po aty, fq.5

⁴ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETER NR 3 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq.1

⁵ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETER NR 4 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq.1-2

⁶ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETER NR 1 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq.7-20

⁷ Po aty, fq. 20-22

⁸ Po aty, fq. 22

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, administrata e Bashkisë bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

Për të mundësuar zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ligji, ju lutem të më vini në dispozicion listën e zyrave elektorale të partisë "Aleanca Demokratike" (AD) në territorin e Bashkisë që ju drejtoni.

Për të vërtetuar ligjshmërinë e kërkesës tonë mund t'i drejtoheni Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në pritje të përgjigjes tuaj,"

Tabelat e mëposhtme japin të pasqyruar me datë 28.06.2019 gjithë komunikimin tim, si nëpërmjet postës elektronike në adresat e personave të kontaktit apo të adresave të vetë bashkisë, si nëpërmjet llogarisë sime personale në portalin <https://pyetshtetin.al/category/kategorite/pushteti-vendor/page/11/> ashtu edhe nëpërmjet Postës Shqipëre, me bashkitë përkatëse për kërkesën e drejtuar nga ana ime këtyre bashkive për dhënie informacioni sipas kërkesave të formuluar në shkresën sa më sipër cituar.

| Nr. rend | Emërtimi i bashkive | Mënyra e dërgesës | | | Mënyra e përgjigjes | | | Përbajtja e përgjigjes | |
|----------|---------------------|-------------------|---------|-------------------------|---------------------|---------------|--------------|------------------------|----|
| | | Posta shqipt | Portali | Llog pers "pyetshtetin" | Posta shqipt | Post Elektron | Pa përgjigje | Pa zyra elekt | |
| 1 | Bashkia Shkodër | | x | x | x | | | x | |
| 2 | Bashkia Lezhë | | x | x | | | x | | ok |
| 3 | Bashkia Bulqizë | | x | | | | x | | |
| 4 | Bashkia Dibër | | x | | | | x | | |
| 5 | Bashkia Durrës | | x | x | | | x | | ok |
| 6 | Bashkia Shijak | | x | | | | x | | |
| 7 | Bashkia Tiranë | | x | | x | x | | x | ok |
| 8 | Bashkia Librazhd | | x | | | | | | |
| 9 | Bashkia Divjakë | | x | | | | x | | |
| 10 | Bashkia Mallakastër | | x | | | | x | | |
| 11 | Bashkia Kuçovë | | x | | x | | | x | ok |
| 12 | Bashkia Devoll | | x | | x | x | | x | ok |
| 13 | Bashkia Korçë | | x | x | x | | | x | ok |

| Nr. rend | Emërtimi i bashkive | Mënyra e dërgesës | | | Mënyra e përgjigjes | | | Përbajtja e përgjigjes | |
|----------|-------------------------|-------------------|---------|-------------------------|---------------------|---------------|--------------|------------------------|----|
| | | Posta shqipt | Portali | Llog pers "pyetshtetin" | Posta shqipt | Post Elektron | Pa përgjigje | Pa zyra elekt | |
| 1 | Bashkia Tropojë | x | | | x | x | | x | ok |
| 2 | Bashkia Has | x | | | | x | | x | ok |
| 3 | Bashkia Kukës | x | | | | | x | | ok |
| 4 | Bashkia Mirditë | x | | | x | x | | x | ok |
| 5 | Bashkia Përrenjas | x | | | | | x | | |
| 6 | Bashkia Pogradec | x | | | x | | | x | ok |
| 7 | Bashkia Maliq | x | | | x | | | x | ok |
| 8 | Bashkia Këlcyrë(Përmet) | x | | | x | | | x | ok |

dorëzuar

dorëzuar

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





PËRFUNDIM 1

Sipas verifikimeve të kryera në terren në të gjitha bashkitë ku partia “Aleanca Demokratike” kishte depozituar listat kandidatët e saj për këshilltarë bashkiakë dhe sipas përgjigjeve të kthyer zyrtarisht nëpërmjet Postës Shqiptare dhe nëpërmjet portalit <https://pyetshtetin.al/category/kategorite/pushteti-vendor/page/11/> rezultoi që subjekti elektor, partia “Aleanca Demokratike”, nuk kishte zyra elektorale të sajat për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Të gjitha këto rezultate i keni të shprehura në raportet e ndërmjetme javore (të dokumentuara me fotot përkatëse të ambienteve të 21 bashkive ku shihet që nuk ka zyra elektorale) që janë shpallur dhe në faqen zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>) dhe referencat e tyre janë dhënë edhe në këtë raport⁹.

V.O: Të gjithë këtë korrespondencë e gjeni të përmbledhur si në dokumentin që i bashkëngjitet këtij raporti ashtu dhe në linkun: [Përmbledhëse e emaileve dhe dëftesave postare dërguar bashkive me objekt kërkesë për dorëzim informacioni.docx](#)

ii.b Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës

Nga komunikimet me kryetarin e Partisë “Aleanca Demokratike” në selinë e Partisë dhe në komunikimet nëpërmjet postës elektronike, z. Eduart Abazi (abazieduart@hotmail.com) në datat 03.06.2019, 20 qershor, 26.06.2019 dhe me mesazhet telefonike e në takimet në selinë e Partisë në datat 20.06.2019 dhe 25.06.2019 ku i janë parashtruar disa herë kërkesat për dhënie informacioni ligjor në lidhje me fushatën për zgjedhjet e qershorit 2019, kthen përgjigje zyrtare ku pohon se nuk kanë kryer asnjë shpenzim sepse nuk kanë kryer asnjë veprim si deri me datë 20 qershor 2019 ashtu dhe deri me datë 26.06.2019. Çdo ndryshim në planet e tyre do të më bëhej i njohur.¹⁰ Të njëjtën përgjigje kthen edhe me dt.26.06.2019¹¹

PËRFUNDIM 2:

Siç u parashtrua dhe në paragrafin e mësipërm “përfundim 1”, nga monitorimet në terren si dhe nga kontaktet dhe nga komunikimi me z. Eduart Abazi, partia “Aleanca Demokratike” nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet zgjedhor deri në fund të muajit qershor 2019.

Nuk janë evidentuar shpenzime për materiale të fushatës zgjedhore si fletushka, reklama, flamuj, etj nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Demokratike” për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019 .

ii.c Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor

I është dërguar emaili z. Eduart Abazi (abazieduart@hotmail.com) për të konfirmuar zyrtarisht pohimet e tij të datës 03.06.2019, i cili ka kthyer përgjigje, me datë 10.06.2019, ku konfirmon që nuk kanë kryer asnjë veprim për llogari

⁹ RAPORTET JAVORE TË NDËRMJETME NR 1,2,3 E 4 TË MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”

¹⁰ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 3 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.1

¹¹ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 4 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.1-2

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





të fushatës zgjedhore¹². Edhe pas mesazheve telefonike dhe takimeve në selinë e Partisë në datat 20.06.2019 dhe 25.06.2019, në emaillet e datave 20.06.2019 dhe 26.06.2019 z. Abazi rikonfirmon përgjigjet e dhëna më parë¹³⁻¹⁴.

V.O: Komunikimin e ekspertës financiare me z. Eduart Abazi për këto probleme i gjeni si në dokumentin bashkëngjitur këtij raporti ashtu dhe në linkun: [Përmbledhje e komunikimit me z Abazi për dhënie informacioni për fushatën zgjedhore qershor 2019.docx](#)

PËRFUNDIM 3:

Nuk është evidentuar mosrespektim i kërkesave ligjore nga subjekti zgjedhor partia “Aleanca Demokratike” për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019.

iii. Përmendja e takimeve dhe komunikimeve të mundshme midis ekspertit financiar dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Komunikimet me subjektin zgjedhor, partia “Aleanca Demokratike”, janë kryer vetëm me kryetarin e saj, z. Eduart Abazi, në selinë e Partisë, në Tiranë, me telefon (nr.0682046005) dhe me mesazhe telefonike si dhe nëpërmjet postës elektronike në adresën abazieduart@hotmail.com.

Këto i keni të shkruara në faqet 5-6, 8 të këtij raporti dhe në raportet javore të monitorimit të dorëzuar tek ju dhe të shpalluar në faqen tuaj zyrtare <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>

V.O: Komunikimin e ekspertës financiare me z. Eduart Abazi për këto probleme i gjeni si në dokumentin bashkëngjitur këtij raporti ashtu dhe në linkun: [Përmbledhje e komunikimit me z Abazi për dhënie informacioni për fushatën zgjedhore qershor 2019.docx](#)

iv. Paraqitja e përgjithshme në lidhje me raportin e monitorimit

IV. Konkluzione mbi monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore

Në lidhje me procesin e monitorimit për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019 për Partinë “Aleanca Demokratike” në funksion të objektit të kontratës së shërbimit dhe në zbatim të udhëzimit nr.2 të KQZ-së datë 01.06.2017 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore, neni 3, në raportojmë konkluzionet në vijim:

- a) Në mbështetje të nenit 24/4, pika 1, të ligjit nr.8580, dt.17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, udhëzimit të KQZ-se nr.1, dt.31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet e afishimit të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, ndryshuar me vendimin nr. 153 të KQZ-së, datë 11.04.2019, rezulton që subjekti zgjedhor, partia “Aleanca Demokratike” nuk ka respektuar detyrimin ligjor që jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve të njoftojë me shkrim kryetarin e bashkisë përkatëse për adresat e sakta të zyrave elektorale.

Partia “Aleanca Demokratike” nuk ka zyra elektorale të hapura për fushatën zgjedhore, nuk disponon kontrata qiraje apo kontrata përdorimi me individë që do të donin të vinin në dispozicion të saj ambiente të tyre.

¹² RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 1 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.5

¹³ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 3 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.3

¹⁴ RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 4 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq.1-2

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail : mira_kastrati@hotmail.it





AUDITUESE LIGJORE FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Gjithashtu nuk ka dhe deklarata të lëshuara prej individëve për kontributin që do të donin të ofronin si dhe nuk ka kosto qirajeje të llogaritura si detyrime për zyra elektorale.

- b) Në lidhje me zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 rezulton që nuk u konstatuan shkelje të ligjit në lidhje me financimin e fushatës elektorale.
- c) Në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor, gjatë monitorimit u vërejt që subjekti zgjedhor nuk disponon dokumentacion ligjor për këtë qëllim meqë nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet elektorale për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019
- d) Në lidhje me respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive, rezulton që gjatë monitorimit nuk u konstatua tejkalim i kufirit maksimal të shpenzimeve meqë nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet elektorale për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019
- e) Në lidhje me kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit, nga partia "Aleanca Demokratike" nuk na u paraqit asnjë lloj dokumenti financiar me shpjegimin që Partia nuk ka pasur dhe nuk ka synim të zhvillojë fushatë elektorale. Si rrjedhojë nuk mund të shprehemi nëse partia "Aleanca Demokratike" ka pasur ose jo transaksione financiare për një periudhë 3 muaj para dhe pas datës së zgjedhjeve. Kështu që nuk u konstatuan shpenzime të kryera në funksion të fushatës elektorale.
- f) Në lidhje me rregullat e brendshme të subjektit elektorale për raportimin e shpenzimeve, nga monitorimi i dokumentacionit financiar dhe i dokumentit "informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata" të përgatitura nga subjekti zgjedhor partia "Aleanca Demokratike", dorëzuar në KQZ me nr. prot të KQZ-së 14543, datë 10.10.2019, shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf>, nuk u konstatua shkelje në lidhje me raportimin e shpenzimeve.
- g) Në lidhje me transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas datës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike, theksojmë që nga partia "Aleanca Demokratike" nuk na u paraqit asnjë lloj transaksion financiar me shpjegimin që Partia nuk ka pasur dhe nuk ka synim të zhvillojë fushatë elektorale. Si rrjedhojë nuk mund të shprehemi nëse partia "Aleanca Demokratike" ka pasur ose jo transaksione financiare të pajustificuara, që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.





AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

II. PËRMBLEDHJE/KËRKESA FORMALE A. PËRMBLEDHJE

II. PËRMBLEDHJE / KËRKESAT FORMALE A. PËRMBLEDHJË

11

| 1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit | | | |
|--|---|----|-----------------------------------|
| | a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja) | Po | Partia "Aleanca Demokratike" (AD) |
| | b) identiteti i personit përgjegjës për financat | Po | Eduart Abazi |
| | c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare | Jo | S'ka |
| | d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës | Jo | S'ka |
| 2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit | | | |
| | Eksperti financiar | Po | Fatmira KASTRATI |
| | Nënshkrimi | Po | Datë 25.11.2019 |
| | Dorëzimi i raportit të monitorimit | Po | Datë 26.11.2019 |
| 3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara | | | |
| | a) Zyrat zgjedhore | Jo | Nuk ka |
| | b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive. | Jo | Nuk ka |
| | c) aktivitetet | Jo | Nuk ka |
| | d) eventet | Jo | Nuk ka |
| | e) materialet propagandistike | Jo | Nuk ka |

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,
 Njësia administrative 5 - Tiranë
 Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;
 e-mail: mira_kastrati@yahoo.it; e-mail: mira_kastrati@hotmail.it





B. ANALIZA

a/ Kërkesat formale

Llogari bankare e veçantë

- Partia "Aleanca Demokratike" nuk ka hapur një llogari bankare të veçantë gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organeve vendore të datës 30.06.2019. Informacioni i shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/06/Llogarite-e-posacme-te-partive-politike-per-fushate-zgjedhore-2019-17062019140636.pdf> për numrin e llogarive për fushatën zgjedhore të vitit 2019, nuk është llogari e veçantë për këtë fushatë por është llogaria e subjektit elektoral për aktivitetin e saj normal të përditshëm. Kjo pohohet edhe nga vetë kryetari i saj, z. Eduart Abazi në emailin e tij të dt. 26.06.2019¹⁵ (mund të shihet tek dokumenti bashkëngjitur raportit si dhe tek linku [Përmbledhje e komunikimit me z Abazi për dhënie informacioni për fushatën zgjedhore qershor 2019.docx](#)).
- PAD nuk ka marrë donacione që e kalojnë limitin ligjor, shumën prej 100,000 leke.
